

20180831491

**L I G J**  
**PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT PËR REVIZION TË**  
**INSTRUMENTIT PËR NDIHMË PARAADERUESE (IPA)**

Neni 1

Në Ligjin për revizion të instrumentit për ndihmë paraaderuese (IPA) („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ numër 66/10, 43/14, 154/15, 27/16 dhe 190/16) në nenin 5 paragrafi (2) pika 5) në alinenë 4 lidhëza "ose" zëvendësohet me presje.

Në alinenë 5 pika në fund të fjalisë zëvendësohet me lidhëzën "ose".

Pas alinesë 5 shtohet aline e re 6, si vijon:

APTIS (APTIS) - së paku nivelin B2 (B2)."

Pika 6) shlyhet.

Pikat 7) dhe 8) bëhen pika 6) dhe 7).

Neni 2

Dispozitat nga neni 5 paragrafi (2) pika 5) nga Ligji për revizion të instrumentit për ndihmë paraaderuese (IPA) („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 66/10, 43/14, 154/15, 27/16 dhe 190/16 ) dhe dispozitat nga neni 1 të këtij ligji me të cilin neni 5 paragrafi (2) pika 5) plotësohet me aline të re 6, nuk do të zbatohen nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji deri më 1 shtator 2018.

Neni 3

Kryerevizori për IPA dhe zëvendësi të cilët janë emëruar në periudhën nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji deri më 1 shtator 2018, janë të obliguar që ta plotësojnë kushtin për njohje të gjuhës së huaj më së voni në afat prej një viti nga dita e emërimit të tyre.

Kryerevizorit për IPA dhe zëvendësit të cilët nuk do ta plotësojnë kushtin për njohje të gjuhës së huaj në afatin e përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni u pushon mandati.

Neni 4

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e botimit në „Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë“.